



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KRYETARI

URDHËRESË

Nr. 3971, datë 24.022019

Për

Një ndryshim në Urdhëresën nr.14228, datë 11.05.2016 mbi "Detajimin në vende parkimi i nënzoneve të destinuara për parkim "NDP" të miratuara me Vendimin e Këshillit Bashkiak, Tiranë nr. 49, datë 11.11.2015 për "Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzoneve të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimin të administruara nga Bashkia e Tiranës"

Me propozim të "Drejtorisë së Transportit dhe Trafikut Rrugor" dhe për efekt administrimi të nënzoneve të destinuara për parkim me pagesë, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja "b" dhe pika 1/1.3, shkronjat "a" dhe "b", nenit 64, shkronjat "a" dhe "b" të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, për "Vetëqeverisjen Vendore"; nenit 7, pika 1, shkronja "e" e pika 10 e po këtij neni dhe nenit 37 të Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr. 48, datë 11.11.2015 për "Krijimin e "Tirana Parking" si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë"; pika 4 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 49, datë 11.11.2015 "Miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzoneve të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimin të administruar nga Bashkia e Tiranës",

URDHËROJ

1. Rishikimin, përcaktimin dhe detajimin në vende parkimi i nënzoneve të destinuara për parkim "NDP" – pjesë e ZAP Nr. 1/Nr.2/Nr.3/Nr.4, si më poshtë vijon:
 - a) Rruga Gjin Bue Shpata - projektit bashkëlidhur kësaj urdhërese, referuar Aneksit 10 të Urdhëresës nr.14228, datë 11.05.2016, fleta 1.
 - b) Rruga Kavajes - projektit bashkëlidhur kësaj urdhërese, referuar Aneksit 2 të Urdhëresës nr.14228, datë 11.05.2016, fleta 1.

2. Për zbatimin e kësaj urdhërese, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Tirana Parking. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Policia Bashkiake, në bashkëpunim me Komisaratin e Qarkullimit Rrugor, Tiranë dhe firma ndërtuese e kontraktuar, për zbatimin e kësaj urdhërese, :

Kjo urdhëresë hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion Veliaj

